



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së dytë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 23.6.2026, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Oktay Kurtesh, Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Feim Osmani, Betim Abdullahu, Faton Marolli, Adnan Ajeti.

Munguan: Lindita Rexhepi Osmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Slavica Stolic - zyrtare nga ZKKK, përfaqësuesit e KFOR-it, Fisnik Dida - përfaqësues nga OSCE-ja, Florent Salihu - përfaqësues nga UNMIK-u.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesi i Komitetit z. Oktay Kurtesh me këtë;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale - znj. Adelina Sahiti;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit dhe Legalizimit - z. Gent Begolli (evidentimi i pronave për komunitetet joshumicë, mënyra e trashëgimisë, korrigjimet e numrave personalë në certifikatat e pronës);
4. Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;
5. Raport i punës së ZKKK-ës për muajin maj 2026 (si dhe informatë lidhur me planifikimin e projekteve të ZKKK-ës për vitin 2026, për komunitetet joshumicë);
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale - znj. Adelina Sahiti
Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për mbledhjen e ardhshme për shkak të mungesës së drejtoreshës nga drejtoria përkatëse.

Pika e tretë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit dhe Legalizimit - z. Gent Begolli (evidentimi i pronave për komunitetet joshumicë, mënyra e trashëgimisë, korrigjimet e numrave personale në certifikatat e pronës)
Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për mbledhjen e ardhshme për shkak të mungesës së drejtorit nga drejtoria përkatëse.

Pika e katërt

Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për mbledhjen e ardhshme.

Pika e pestë

Raporti i punës së ZKKK-ës për muajin Maj 2026 (si dhe informatë lidhur me planifikimin e projekteve të ZKKK-ës për vitin 2026, për komunitetet joshumicë)
Sllavica Stolic – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se me siguri raportin e ZKKK-ës e keni lexuar, meqë kryesisht edhe si muajt e mëparshëm nuk ka ndonjë risi, mirëpo mendoj se nga ky muaj do të kemi punë më shumë.

Faton Marolli – tha se meqë ZKKK ka një buxhet, prandaj shtroi pyetje për znj. Stolic se sa është ai buxhet dhe a kanë diçka në planifikim lidhur me buxhetin ashtu siç ka qenë vitin e kaluar për ndihmë për komunitetet joshumicë.

Sllavica Stolic – lidhur me pyetjen e z. Marolli tha se nuk ka informatë se sa është buxheti për ZKKK, prandaj lidhur me këtë çështje do të bisedojmë në takimin e ardhshëm, pasi që do të jetë prezent edhe znj. Qefsere nga ZKKK, ndoshta ka më shumë informata.

Oktay Kurtesh - duke u ndërlidhur në diskutim tha se lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Marolli, shtoi se pasi që erdhi Betimi ndoshta kishte mundur të na jap ndonjë informatë lidhur me buxhetin e ZKKK-ës.

Faton Marolli – duke u ndërlidhur në diskutim tha se nëse keni mundësi të na informoni se a ka buxhet ZKKK-ja, sa është ai buxhet dhe a ka ZKKK-ja ndonjë planifikim lidhur me komunitetet siç keni pasur tri vitet e fundit si kornizë-buxhet për ndihmë të komuniteteve si p.sh. pako ushqimore, pako higjienike etj., si dhe diçka për investimet kapitale.

Betim Abdullahu – lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Marolli tha se ZKKK-ja vitin e kaluar ka pasur 177 mijë euro buxhet komplet si zyrë. Prej këtyre 177 mijë eurove janë me ndarje, 50 mijë euro janë paga, pra që shkojnë për zyrë, mallra janë 120 mijë euro të planifikuara edhe shërbime komunale kanë qenë 18 mijë euro. Ndërsa sa i përket projekteve të cilat i kemi zbatuar viteve të kaluara si p.sh projekti për higjienë për familje të komuniteteve, dhuratat për fëmijë kanë përfunduar kontratat kornizë që kanë qenë tri vite. Ai në vazhdim tha se është një projekt që nuk është kryer ku Klaudia është menaxhere, dhe unë edhe në mbledhjen e kaluar i kam thënë Klaudies se duhet të vijë për ta bërë porosinë sepse është viti i fundit që ka me u zbatuar e që ka të bëjë me mallrat dhe pakot higjienike, pakot ushqimore etj. Ai njëherazi tha se ka tentuar vitin e kaluar me e vazhduar kontratën për materialet didaktike dhe shkollore për fëmijët por edhe për ushqime, por na i ka kthyer Drejtoria e Financave për shkak që buxhetit është vonuar me votim dhe nuk kishim të holla të planifikuara (na e kanë kthyer dy herë). Prandaj lidhur me këtë çështje tha se duhet kontaktuar me drejtorin e administratës që me u munduar me i shtyrë projektet ashtu siç i kemi pasur, pasi që ky buxhet është i ndarë, por është brenda Drejtorisë së Administratës.

Ai mes tjerash tha se do të ishte mirë që ne t'i përgatisim projektet dhe t'i dorëzojmë në drejtorinë përkatëse, mirëpo do të ishte mirë që të kemi garancion edhe nga Kabineti i kryetarit që mos me na e harxhuar atë shumën që e kemi siç ka ndodhur vitin e kaluar.

Nenad Miladinovic – sa i përket buxhetit për investime kapitale tha se ne e kemi buxhetin për investime kapitale, i cili shfrytëzohet vetëm në emër të investimeve kapitale. Prandaj kisha pasur dëshirë me dëgjuar nga Betimi a është ende ashtu njëjtë apo jo.

Betim Abdullahu – lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Miladinovic tha se po është e vërtetë se ky buxhet për investime kapitale është i ndarë nga buxheti i ZKKK-ës. Një pjesë e diskutimeve të diskutuesve më lart nuk ka mundur të transkribohet për shkak të moszërimit gjatë diskutimit.

Nenad Miladinovic - propozoi që për takimin e ardhshëm të ftohet drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale.

Mirsada Behluli – duke u pajtuar me propozimin e z. Miladinovic tha se do të ishte mirë që të ftohen të dy drejtoritë, si Drejtoria e Financave dhe ajo e Investimeve Kapitale dhe ta shohim se ku qëndron problemi.

Një pjesë e diskutimeve të diskutuesve më lartë nuk ka mundur të transkribohet për shkak të moszërimit gjatë diskutimit.

Feim Osmani - duke u ndërlidhur në diskutim tha se ne duhet të vazhdojmë me ftesat ashtu siç e kemi planin e punës, ku në momentin që e caktojmë mbledhjen e caktojmë edhe rendin e ditës dhe përcaktohem se cilat drejtori do t'i ftojë për takim, ftesa duhet t'ju shkojë menjëherë nuk ka rëndësi se sa ditë përpara.

Oktay Kurtesh - propozoi që të formohet një grup nga anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe të caktohet një takim tek Kryetari i Kryeqytetit z. Përparim Rama, apo të ftohet kryetari në mbledhjen e komitetit.

Pika e gjashtë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës sipas raportimit të përfaqësuesve të komuniteteve, nuk patën ndonjë shqetësim lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutimet e diskutuesve nuk kanë mundur të transkriptohen për shkak të moszërimit gjatë diskutimit, për çka edhe ju kërkoj falje anëtarëve të komitetit dhe i falënderoj për mirëkuptim.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesues i Komitetit
Oktay Kurtesh

